

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)**

OPERATORIT EKONOMIK “TIRANA AUTO” SHPK

Adresa: Tirane Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Kilometri 1, Rruga Dytësore

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar** (marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues).

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Loti 1: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), autoveturë elektrike”, me Nr. REF-92041-22-2023** për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga dita e dorëzimit të mjeteve në Bashkinë Tiranë, për secilin lot. Afati i levrimit të mjeteve 90 (nëntëdhjetë) ditë pune, termat e leasing 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj, për secilin lot.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini Nr. 105 datë 29 Dhjetor 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

➤ **Operatori ekonomik “Tirana Auto” sh.p.k, NIPT K82318007Q**

Vlera e ofertës pa tvsh = 214.200.000 (dyqind e katërmbëdhjetë milion e dyqind mijë) lekë.

➤ **Operatori ekonomik “ALBANIA CAR RENTALS” SH.P.K, NIPT K92311013D**

Vlera e ofertës pa TVSH = 227.092.500 (dyqind e njëzet e shtatë milion e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë.

➤ **Operatori ekonomik “PORSCHE ALBANIA SH.P.K, NIPT K51914014P**

Vlera e ofertës pa tvsh = 0 (zero) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

➤ **Operatori ekonomik “PORSCHE ALBANIA SH.P.K, NIPT K51914014P**

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe të Kreut X, Nenit 82, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Porche Albania” shpk nga ku rezultoi si më poshtë:

Pas hapjes së ofertave, u konstatua se Operatori Ekonomik “Porche Albania” shpk nuk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik, dokumentacionin e duhur ligjor, ekonomik dhe teknik. Ky fakt i konstatuar u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave. Mungesa e dokumentacionit ekonomik, ligjor dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit ekonomik “Porche Albania” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë te pavlefshme.**

Duke iu referuar procedurës së mësipërme meqënëse procedura është marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, **ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues,** ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm i identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit është:

- **Operatori ekonomik “Tirana Auto” sh.p.k, NIPT K82318007Q**

Vlera e ofertës pa tvsh = 214.200.000 (dyqind e katërbëdhjetë milion e dyqind mijë) lekë.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.